



UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"UKSHIN HOTI"  
PRIZREN

## Fakulteti i Filologjisë

# KALENDARI I AKTIVITETEVE TË FAKULTETIT TË FILOLOGJISË 2022-2023

Prizren, 2023

**UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” - PRIZREN**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**KALENDARI I AKTIVITETEVE TË FAKULTETIT TË FILOLOGJISË**

**(Viti akademik 2022-2023)**

**Përgjegjës për publikim: Dekani, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj**

**Komisioni për përgatitje të publikimit:**

**Prof. asoc. dr. Flamur Shala**

**Prof. asoc. Sermin Turtulla**

**Prof. asoc. dr. Ilir Krusha**

**Ass. Fikret Ramadni**

**Stud. Olza Shemsedini**

**Lektor: Ass. Fikret Ramadani**

**Ballina: Msc. Tarik Han**

**Prizren, 2023**

## **FJALA E DEKANIT**

Në cilësinë e dekanit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit "Ukshin Hoti" - Prizren, kam kënaqësinë e veçantë t'ju prezantoj Kalendarin e aktiviteteve të Fakultetit të Filologjisë për vitin akademik 2022-2023.

Kalendari i aktiviteteve për vitin akademik (2022-2023) që publikohet për herë të parë, me qëllimin që të bëhet traditë publikimi i tij i përvitshëm, përmbledh përpjekjet dhe arritjet e stafit akademik, të studentëve dhe të stafit administrativ. Nga menaxhmenti dhe stafi akademik e deri të stafi administrativ dhe studentët, secili anëtar i Fakultetit ka dhënë kontributin e vet në organizimin dhe realizimin e një game të gjerë të aktiviteteve të ndryshme.

Përmes këtij kalendari të përvitshëm, ne synojmë të dokumentojmë dhe të përshkruajmë në mënyrë të qartë dhe të plotë shumicën e ngjarjetve dhe të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë vitit akademik. Në këtë mënyrë, ne kemi një pasqyrë të plotë të suksesit dhe përpjekjeve tona për të përmbushur misionin tonë akademik, për të promovuar kulturën, njohuritë në fushën e filologjisë dhe të realizimit të misionit të tretë të Universitetit.

Dua të përgëzoj dhe të falënderoj me shumë respekt të gjithë stafin akademik për përkushtimin e tyre të pakursyer në përgatitjen dhe arsimimin e studentëve tanë. Po ashtu, falënderoj stafin administrativ për punën e tyre të palodhur në mbështetje të funksionimit të përditshëm të fakultetit.

Një falënderim i veçantë shkon për studentët tanë, të cilët kanë treguar angazhim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm në aktivitetet e tyre mësimore dhe jashtëmësimore, të cilët janë forca jonë e frymëzimit dhe e suksesit dhe i inkurajojmë që të punojnë edhe më shumë, sepse arritjet e tyre pasqyrojnë misionin e Fakultetit të Filologjisë.

Krejt në fund, dua të theksoj se ky kalendar i aktiviteteve është një dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta dhe e bashkëpunimit të të gjithë anëtarëve të komunitetit tonë në fakultet. Së bashku, le të vijojmë të ndërtojmë një mjedis të frytshëm dhe të suksesshëm për zhvillimin e shkencës, arsimit e kulturës dhe të kontributit në komunitet.

Ky kalendar i aktiviteteve le të shërbejë si një nismë, me synimin që të jetë i përvitshëm dhe të ngritet cilësia e përgatitjes së këtij Kalendari në vitin e ardhshëm akademik.

Bashkërisht, nën frymën e bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët, mund të krijojmë ndryshime të mëdha për të mirën e njësisë sonë akademike, të Universitetit dhe të vendit tonë në përgjithësi.

Prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj  
Dekan i Fakultetit të Filologjisë



## **Përrurimi i veprës “Bulbëri mendimesh” e poetit Bajram Bekteshi**

Me rastin e festave të Nëntorit përrurohet vepra poetike “Bulbëri mendimesh” e autorit Bajram Bekteshi. Përr veprën folën recensentët: prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe prof. Ahmet Qeriqi, të cilët vlerësuan lart veprën e autorit prizrenas. Përrurimi u mbajt në amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Ukshin Hoti”, më 25.11.2022.

Ky është njëherazi edhe një kontribut i Universitetit “Ukshin Hoti” përr komunitetin.



## **Themeluesi i Gjinnazit “Loyola Gymnasium”, Pater Walter Happel SJ, vizitoi Fakultetin e Filologjisë**

Patëm nderin dhe kënaqësinë të kemi në vizitë themeluesin e Gjinnazit “Loyola Gymnasium”, ish-drejtorin Pater Walter Happel SJ dhe kolegë të kësaj shkolle, Pal Balën etj. Ky gjinnaz ishte dhe mbetet me emër jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Qëllimi i kësaj vizite të mikut tonë është bashkëpunimi edhe në të ardhmen në mbështetje të projekteve për të rinjtë tanë.

Ishte një takim shumë miqësor dhe me qëllim të bashkëpunimit me Fakultetin e Filologjisë (respektivisht me Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane) të Univetsitetit “Ukshin Hoti”. Pater W. Happel i shërbeu Prizrenit deri në pensionim (2005-2015) dhe u rikthye përsëri t'i shërbejë këtij qyteti, respektivisht të rinjve tanë.

Vlen të përmendet se Pater Walter Happel është shpallur nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit “Qytetar Nderi i Prizrenit”, në vitin 2015. Ai është vlerësuar lart për kontributin e tij për edukimin dhe arsimimin e të rinjve të qytetit të Prizrenit me rrethinë e më gjerë përmes ALG “Loyola”, i cili në vitin 2005 bashkë me disa bashkëpunëtorë vendës këmbënguli që ALG “Loyola” të themelohet në Prizren.

Respekt, vlerësime të larta dhe shëndet për mikun tonë gjerman!  
E falënderojmë shumë Pater Walter Happel-in dhe z. Pal Balën për vizitën!



## Fakulteti i Filologjisë pjesë e Konferencës Ndërkombëtare Shkencore “BRIDGE 2022”

Më 9 – 10 dhjetor 2022, u zhvilluan punimet e Konferencës Ndërkombëtare Shkencore “BRIDGE 2022”. Organizatorë të kësaj ngjarje shkencore ishin: Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Universiteti Pamukkale – Turqi, ITP – Pizren dhe DokuFest.

Nga Fakulteti i Filologjisë, morën pjesë: prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj me punimin: *Synchronic and diachronic view of the verbs go, walk, ride*. Prof. asoc. dr. Izer Maksuti me kumtesën: *The Change of a Lexion During the Pandemik*. Prof. ass. dr. Ilir Krusha dhe prof. ass. dr. Shpetim Zymberaj me kumtesën: *Analysis of the catalog of criteria for the assessment of learning materials*. Ass. Rezarta Ramadani me kumtesën: *Bilingualism: Mental Wellbeing and Learners’ Cognitive Abilities*. Ass. Fikret Ramadani me kumtesën: *Controversial style in dealing with national identity of R. Qosje and Ismail Kadare’ s writings*. MSc. Elita Omaj me kumtesën: *Mythological elements in the work Who brought Doruntina by Ismail Kadare*. MSc. Adelina Beqaj me kumtesën: *Textual analysis of some advertisements in the Albanian language*.

Vlen të theksohet se pas përfundimit të kumtesave, pati diskutime mjaft produktive në mes të pjesëmarrësve.



## Nisma për bashkëpunim

Një grup i studentëve të Universitetit të Tiranës, të shoqëruar me disa mësime të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, qëndruan për vizitë në Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren.

Fillimisht, takimin e hapi dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj. Në cilësinë e nikoqirit, ai falënderoi studentët dhe profesorët duke shprehur që takime të tilla të kemi më shpesh dhe të mos mungojë asnjëherë bashkëpunimi ndërakademik e institucional. Në anën tjetër, Zv. dekania e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, prof. Elsa Rakiplari, pasi falënderoi kolegët për mikpritjen, theksoi se përveç bashkëpunimeve të stafit akademik duhet të drejtojmë energjitë edhe në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet studentëve të të dy universiteteve.

Kurse mendimet e profesorëve të tjerë dhe studentëve që ishin të pranishëm në këtë ngjarje hapën rrugë të reja diskutimi dhe i dhanë frymë këtij takimi.

Pas përfundimit të takimit, të pranishmit patën mundësi të njihen nga afër me Kampusin e Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren.





## **Këshilli i Studentëve mbajti mbledhjen e radhës me dekanin dhe shefat e programeve (01.03.2023)**

Në mbledhjen e Këshillit të Studentëve të Fakultetit të Filologjisë, ishte i ftuar dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj, bashkë me shefat e degëve: ass. Rezarta Ramadani dhe ass. Fikret Ramadani.

Në këtë mbledhje u diskutua për:

Fillimin e semestrit veror;

Bashkëpunimin mes stafit akademik dhe studentëve;

Vizitat studentore.

Falënderojmë dekanin dhe shefat e programeve për kohën, gatishmërinë dhe bashkëpunim me studentë.

Arbnor Thaqi,

Kryetar i Këshillit të Studentëve të Fakultetit të Filologjisë



## Marrëveshje bashkëpunimi mes Universitetit “Ukshin Hoti” dhe Albanian Institute of Cultural Studies

Më 10.03.2023 u nënshkura marrëveshja e bashkëpunimit mes Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren dhe Albanian Institute of Cultural Studies me seli në Prishtinë. Marrëveshjen e bashkëpunimit mes të dyja institucioneve e nënshkruan rektori i Universitetit “Ukshin Hoti”-Prizrem, prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj, dhe drejtuesja e Albanian Institute of Cultural Studies, dr. Elona Gjata. Të pranishëm, me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, ishin: prorektorët prof. ass. dr. Ziriye Hasani, prof. ass. dr. Adelinë Rakaj, Sekretari i Përgjithshëm, Msc. Nexhemedin Krasniqi, prof. asoc. dr. Izer Maksuti dhe dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj. Synimi i kësaj marrëveshjeje është nisma dhe forcimi i bashkëpunimit në veprimtari të përbashkëta shkencore në fushën e gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe të filologjisë, me qëllim të realizimit të projekteve të përbashkëta (konferenca, seminare, projekte studimore etj.) për të kontribuar në zhvillimin e studimeve albanologjike shqiptare si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Të dyja palët, të cilat nënshkruan këtë marrëveshje, u zotuan që të japin ndihmesën e vet në projekte të përbashkëta në të mirë të zhvillimit të filologjisë shqiptare.



## **U promovua libri “Zanorja ë në gjuhën shqipe (ë-ja e patheksuar)” e dr. Elona Gjatës, studiuese nga Tirana**

Në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, është bërë promovimi i librit “*Zanorja ë në gjuhën shqipe (ë-ja e patheksuar)*” e autorës dr. Elona Gjata, studiuese nga Tirana.

Me këtë rast nga një fjalë përshëndetëse e mbajtën rektori – prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj dhe dekani i Fakultetit të Filologjisë prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj. Rektori Krrabaj dhe dekani Beqiraj e përgëzuan autoren për punën e bërë, dhe theksuan se për Universitetin është nder që po bëhet promovimi i një libri të rëndësishëm i një autoreje nga Tirana. “Ky studim sjell një hulumtim shkencor të thelluar në fushën e fonetikës së shqipes, respektivisht lidhur me ë-në e patheksuar në gjuhën shqipe, duke filluar nga shkrimet e para të shqipes e këndeje”, theksoi dekani Beqiraj.

Ndërkaq me kumtesa u paraqitën: prof. asoc. dr. Flamur Shala, prof. dr. Rami Memushaj, prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku. Ndërsa Fjalën përmbyllëse e kishte prof. asoc. dr. Sermin Turtulla, prodekane e Fakultetit të Filologjisë.

Autorja e librit dr. Elona Gjata shprehu mirënjohjen e saj për të gjithë ata që kanë dhënë ndihmën e tyre në hartimin e këtij libri, i cili ka qenë edhe disertacioni i saj. Ajo falënderoi udhëheqësin e temës doktrale, prof. dr. Rami Memushajn. “E falënderoj për ndihmën e dhënë në lidhje me literaturën që nevojitej për punimin e kësaj teme dhe për durimin që ka treguar në këto vite, duke u treguar gjithnjë i gatshëm dhe i palodhur. E falënderoj për mendimet e këshillat shkencore. Kam mësuar shumë prej tij.”, u shpreh studiuesja Gjata.

Siç theksohet, ky libër ka si objekt studimi zanoren [ë] të patheksuar në gjuhën shqipe, duke vënë theksin në traditën shkrimore të gjuhës sonë. Për të nxjerrë në pah gjendjen e hershme të përdorimit të ë-së së patheksuar, autorja Gjata ka marrë në analizë fragmente nga autorët të vjetër dhe nga autorë të shekujve të mëvonshëm. Autorja thekson se duke hulumtuar nëpër këto rrafshe kohore kemi parë si është përdorur kjo zanore nga autorët e marrë në shqyrtim në pozicione të ndryshme në fjalë, si dhe marrëdhënien që kjo zanore krijon me theksin e fjalës.



### **Fakulteti i Filologjisë mirëpriti maturantët e shkollave të mesme**

Në kuadër të parapërgatitjeve për vitin e ri akademik 2023-2024 dhe angazhimit për orientimin në karrierë, më 30 dhe 31 maj, Fakulteti i Filologjisë mirëpriti maturantë të shumtë në ambientet e fakultetit.

Gjatë këtyre dy ditëve, nxënësit patën mundësi bashkëbisedimi me stafin akademik, administrativ dhe Parlamentin Studentor, po ashtu patën mundësi të njihen nga afër me universitetin në përgjithësi, kushtet e regjistrimit, mundësitë për bursa, mundësitë për mobilitet, mundësitë e zhvillimit në karrierë dhe me jetën dhe aktivitetet studentore.

Me këtë rast falënderojmë shkollat e mesme të cilat ishin të gatshme dhe shprehën interesim të na vizitojnë dhe t'i njoftojnë maturantë me universitetin. Posaçërisht, falënderojmë zv. drejtorin e Gjymnazi “Gjon Buzuku” – Prizren, prof. Mejdin Rrahmani dhe stafin e kësaj shkolle për vizitën e organizuar në Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren.



## **Vizitë në Fakultetin e Filologjisë së UP-së dhe në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”**

Studentët e Departamentit të Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane, udhëhequr nga dekani i Fakultetit të Filologjisë prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe profesorët: prof. asoc. dr. Izer Maksuti dhe prof. ass. dr. Vilson De Marku vizituan Fakultetin e Filologjisë, gjegjësisht Departamentin e Gjuhës Gjermane në Universitetin e Prishtinës.

Kjo vizitë u përcoll me tri aktivitete: së pari, studentët morën pjesë në leximin letrar të autoreve austriake Maria Hofer, ku ishin të pranishëm: udhëheqësi i programit austriak për shkëmbim akademik dhe ndërkombëtarizim (OeAD), dr. Arnulf Knafel, lektorët austriakë nga i gjithë rajoni. Pas leximit letrar studentët tanë patën mundësinë të diskutojnë me autoren, si dhe të njihen e të shkëmbejnë përvojat edhe me kolegët e tyre nga Universiteti i Prishtinës.

Më pas, aktivitetin tonë e vazhduam me vizitën e Bibliotekës Austriake në Fakultetin Filologjisë. Këtu studentët u informuan për numrin e librave që gjenden në këtë bibliotekë, mënyrën e huazimit, si dhe funksionimin e sistemit bibliotekar.

Aktivitetin e përmbyllëm me një vizitë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare “Pjetër Bogdani”, ku nën guidën profesionale të punonjësve të këtij institucioni vizituam sallat e leximit dhe ekspozitat, të cilat aktualisht janë të ekspozuara në Bibliotekën Kombëtare.



### **Këshilli i Studentëve mbajti mbledhjen e radhës me dekanin dhe shefat e programeve (18.04.2023)**

Në mbledhjen e Këshillit të Studentëve të Fakultetit të Filologjisë, ishte i ftuar dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj, bashkë me shefat e degëve: prof. asoc. dr. Ilir Krusha, ass. Rezarta Ramadani dhe ass. Fikret Ramadani.

Në këtë mbledhje u diskutua për:

Mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve,

Organizimin e provimeve për afatin e PRILLIT.

Falënderojmë dekanin dhe shefat e programeve për kohën, gatishmërinë dhe bashkëpunim me studentët.

Arbnor Thaqi,

Kryetar i Këshillit të Studentëve të Fakultetit të Filologjisë



**Prof. Philippe Vaesken nga Universiteti Lille vizitoi Universitetin “Ukshin Hoti”,  
Prizren**

Universitetin “Ukshin Hoti” – Prizren, e vizituan z. Donato Giuliani, Këshilltar për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulture, prof. Philippe Vaesken nga Universiteti i Lille, znj. Fikrije Pllashniku-Tetaj, Sekretare e Përgjithshme në Departamentin për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulture dhe znj. Valentina Kapiti nga Aleanca Franceze.

Ata janë pritur në takim nga dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj, Sekretari i Përgjithshëm z. Nexhmedin Krasniqi, prodekania e FF-së prof. asoc. dr. Sermin Turtulla, si dhe senatori prof. asoc. dr. Izer Maksuti. Në takim është diskutuar mundësia e zgjerimit dhe thellimit të bashkëpunimit në mes Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren dhe universiteteve franceze, me theks të veçantë me Universitetin *Lille* në Francë.

Me këtë rast profesorit Vaesken iu prezantuan hapësirat e Këndit Francez në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren.



### **U promovua libri i prof. Agim Vincës, “Saga e shkronjave shqipe (Kongresi i Manastirit: të thëna dhe të pathëna)”**

Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, të enjten e ka vizituar prof. dr. Agim Vinca, njëri nga poetët më të njohur bashkëkohorë shqiptarë dhe njëri ndër studiuesit më të dalluar të letërsisë shqipe.

Ai është pritur në takim fillimisht nga rektori i Universitetit prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj, i cili i ndau edhe mirënjohje për kontributin e tij dhënë për letërsinë shqipe dhe në edukimin e brezave. Vinca ka qenë profesor në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëronte Letërsinë e sotme shqipe. Tani është pensionuar dhe vazhdon të merret me letërsi. Agim Vinca merret edhe me përkthime letrare dhe shkrimin e veprave studimore për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Përkthimet e tij janë kryesisht nga gjuha franceze në gjuhën shqipe.

Pas takimit me rektorin, Vinca kishte një bashkëbisedim me studentët dhe profesorët e Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit të Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren. Me këtë rast nga një fjalë rasti mbajtën edhe prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj, dekan në Fakultetin e Filologjisë, prof. dr. Jashar Kabashi dhe prof. ass. dr. Gjylë Totaj.

Shkas i takimit ishte botimi i librit të fundit të prof. Vincës: “Saga e shkronjave shqipe (Kongresi i Manastirit: të thëna dhe të pathëna)”.

Fjala është për një studim kritik mbi këtë ngjarje të madhe të historisë dhe kulturës shqiptare, që zhvilloi punimet në qytetin e Manastirit, atëbotë qendër e Vilajetit, prej 14-22 nëntor 1908.



Autori konsideron se Kongresi i Manastirit zgjidhi një nga çështjet fundamentale të kulturës shqiptare: atë të alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe, që i hapi rrugë edhe njësimit të drejtshkrimit të saj rreth shtatëdhjetë vjet më vonë.

### **Në Universitetin “Ukshin Hoti” - Prizren është bërë përrurimi i Këndit Francez**

Në Universitetin “Ukshin Hoti” - Prizren, të enjten, është bërë përrurimi i Këndit Francez. Me këtë rast është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Universitetit dhe Ambasadës së Francës në Kosovë.

Në ceremoninë e organizuar, shiritin e hapjes e kanë prerë, rektori i Universitetit, prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj, Ambasadori i Francës, zt. Olivier Guéro, kryetari i komunës së Prizrenit z. Shaqir Totaj dhe mësimdhënësit e Fakultetit të Filologjisë.

Me këtë rast u theksua se tani e tutje do të shkëmbehen përvojat me universitetet franceze dhe se Këndi Francez do të jetë një mundësi e mirë për njohjen e kulturës franceze.



### **Për herë të parë u publikua Fjalori i madh drejtshkrimor i gjuhës shqipe në formë digjitale**

Më 10 qershor, 2023 (e shtunë), ora 11.00, në Universitetin “Ukshin Hoti”, në amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik, në Prizren për herë të parë u publikua Fjalori i madh drejtshkrimor i gjuhës shqipe në formë digjitale.

Sasia e fjalëve që është pasqyruar në këtë fjalor është mbi 100.000 sosh, me të gjitha format e tyre gramatikore, si dhe informacione të tjera për çdo fjalë. Me një fjalës të përzgjedhur me kujdes,

me mbi 8.000.000 forma fjalësh, tashmë të digjitalizuara në mënyrë të përsosur dhe lehtësisht të qasshme për çdo shqiptar përmes internetit.

Të pranishëm në këtë paraqitje publike do të jenë edhe anëtarët e Këshillit Kombëtar Shkencor për gjuhën shqipe:

Shqipëri: prof. dr. Emil Lafe, prof. dr. Enver Hysa, prof. asoc. Adelina Çerpja, prof. asoc. Anila Çepani.

Maqedoni e Veriut: prof. dr. Mustafa Ibrahim, prof. dr. Asllan Hamiti, prof. dr. Ismet Osmani.

Kosovë: prof. dr. Hysen Matoshi, prof. dr. Bahri Koskoviku.

Nikoqir, Universiteti i Prizrenit: Rektori z. Mentor Alishani, dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj, prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku dhe ass. Fikret Ramadani.



### **Studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” të Prizrenit, pjesëmarrës në Konferencën shkencore ndërkombëtare**

Universiteti i Tiranës në Shqipëri ka organizuar Konferencën shkencore ndërkombëtare, e cila për temë boshte kishte: *“Kërkimi shkencor dhe edukimi në perspektivën e studentëve dhe studiuesve të rinj UT flet me zërin e studentëve”*. Në këtë konferencë morën pjesë njëzet e nëntë (29) institucione të ndryshme dhe gjithsej dyqind e nëntëdhjetë e pesë (295) studentë.

Konferenca u organizua nga të gjitha njësitë akademike të UT-së, përfshirë të gjitha fushat e studimeve.

Nga Universiteti i Prizrenit dhe Fakulteti i Filologjisë morën pjesë katër studentë të Departamentit të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Rina Perolli dhe Fjolla Qellopeku prezantuan për temën: *E folmja e Gjakovës dhe karakteristikat e saj*, kurse Egzon Jashari dhe Fatlum Jashari prezantuan temën: *Struktura dhe funksioni i kallëzuesit emëror në shqip: studim kontrastiv ndërmjet shqipes gjermanishtes dhe anglishtes*.

Në hapjen e konferencës ishin: Ministrija e Arsimit dhe e Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe rektori i UT-së e i UP-së, dekanë, profesorë e studentë të fushave të ndryshme.

Një seancë shkencore është drejtuar edhe nga Fatlum Jashari, i cili është student i vitit të tretë në Prizren.



### **Pjesëmarrja e profesorëve të Fakultetit të Filologjisë në Konferencën e Dytë Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë 09 qershor 2023**

Në Konferencën e Dytë Shkencore Ndërkombëtare me temë bosht: “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”, organizuar nga Fakulteti i Filologjisë i Universiteti “Fehmi Agani”, në Gjakovë, më 09 qershor 2023, morën pjesë edhe dy profesorë të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren: prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj (bashkautorë me prof. ass. dr. Shemsi Hazirin dhe prof. ass. dr. Senad Nezirin) me kumtesën me titull “Studim kontrastiv i disa parafjalëve ndërmjet shqipes dhe anglishtes” dhe prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku me kumtesën me titull “Anglicizmat prurje të reja apo sfidë për gjuhën shqipe”.

Konferenca i zhvilloi punimet në disa senaca paralele, ku morën pjesë studiues të njohur prej disa universitetesh, si: nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi etj.

Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj pati takime edhe me dekanin e Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Kamber Kamberi dhe me kolegë të tjerë të Departamentit të Gjuhës Shqipe të FF-së – UFAGJ, ku u bisedua për mundësi të bashkëpunimit ndëruniversitar.



### **Java e Bibliotekës në Kosovë - Prizren**

Java e Bibliotekës në Kosovë u organizua edhe në Prizren. Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof.asoc.dr. Xhafer Beqiraj mori pjesë në këtë veprimtari dhe u paraqit me kumtesën: “Roli dhe rëndësia e referencave dhe citateve në studime dhe monografi” në sesionin e dytë me temë bosht “Baza e shkrimit dhe e botimit të një monografie”, që u organizua nga Biblioteka e Qytetit të Prizrenit, më 24 maj 2023, e cila drejtohet nga drejtoresha Sahadete Sadikaj – Kukaj. Në këtë sesion me kumtesa u paraqiten edhe Orhan Bislimi, Skender Susuri, Ibrahim Skenderi, Rrahman Rexhaj dhe krijues të tjerë.

22.06.2023



### **Profesor Millaku pjesëmarrës në Javën e Albanologjisë 14/2023**

Profesor Millaku pjesë e konferencës shkencore të organizuar nga Institutit i Albanologjisë në Prishtinë. Në rastit e 70-vjetorit të themelimit të Institutit Albanologjik, profesor Millaku kumtoj me temë: Ndhimesa e Emil Lafes për revistën “Gjuha shqipe” Kontributi i prof. Emil Lafes për gjuhën, kulturën dhe shoqërinë tonë, në përgjithësi është i shumanshëm, i shëndoshë dhe prodhimtar. Si një gur i çmuar që ka shkëlqyer kudo që ka kontribuar, ai ndershëm e në rrugë profesionale i shërbeu vendit, i cili shërbim, përmes punës shkencore të tij hapi dhe themelet e kodifikimit të gjuhës. Kontributi shkencor i prof. Lafes dhe dashamirësve të tjerë është bazament jetësor për gjuhën dhe kulturën tonë.

Punimi i prof. Millakut ka pesë objektiva për t’i analizuar dhe trajtuar:

Çështja e parë është vështrimi i punimit shkencor: “Kyçem në politikë ... – shpërfytyrim i të folurit shqip”. Grupi i fjalëve “kyçem në politikë”, fjala kyçem, a është fjalë sllave apo e ndonjë gjuhë tjetër? Çështja e terminologjisë që trajtohet nga prof. Lafe është çështje e rëndësisë së veçantë shkencore dhe kombëtare.

Emil Lafe për studiuesit e tjerë, ka botuar disa studime në revistën “Gjuha shqipe”, të cilët janë: Sami Frashëri, Dritëro Agolli, Idriz Ajetit, Selman Rizën, Mahir Domi, Dhimitër Kamarda, Oda Buchholz e ndonjë tjetër.

Studiuesit e tjerë që kanë botuar për Emil Lafen në revistën “Gjuha shqipe” janë: Shefkije Islamaj, Xhevat Lloshi, Kujtim Kapllani, Viktor Bakillari, Emin Kabashi, Naim Berisha, Artan Xhaferaj e ndonjë tjetër.

Çështja e fundit për këtë punim është studimet e botuara të profesor Emil Lafes në revistën “Gjuha shqipe”, i cili ka botuar dhjetëra studime, të cilat janë me interes për gjuhën standarde, për kulturën, për normën, drejtshkrimin e shqipes, për historinë e gjuhës, për leksikun. Disa nga ato do t’i analizojmë në pika thelbësore.

Programi:

<https://institutialbanologjik.org/index.php/2023/06/10/date-19-21-06-2023-java-e-albanologjise-14-2023/>



### **Mirënjohje dhe falënderime për z. Agron Qovanaj**

Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj, i jep mirënjohje z. Agron Qovanaj për kontributin e tij të jashtëzakonshëm si zyrtar për Shërbime Studentore në Fakultetin e Filologjisë dhe e përgëzon për ngritjen në pozitë zyrtare më të lartë në Universitet.

Në rolin e tij si zyrtar për Shërbime Studentore, z. Qovanaj ka qenë shembull dhe ka kultivuar një kulturë të bashkëpunimit dhe të përkushtimit në punë si me studentë e stafin administrativ, ashtu edhe me stafin akademik. Kjo ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve studentore në Fakultetin e Filologjisë. Puna e suksesshme dhe profesionale e tij ka lënë një ndikim të thellë në zhvillimin e Fakultetit të Filologjisë.

Dekani, në emër të vet dhe të kolegëve të Fakultetit të Filologjisë, e falënderon z. A. Qovanaj dhe i është shumë mirënjohës për kontributin e dhënë, dhe për ndikimin e madh që ka pasur në rritjen e cilësisë së shërbimeve studentore në njësinë akademike.

Shëndet e shumë suksese z. Agron Qovanajt!



**Prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku dhe prof. ass. dr Dardan Vuniqi ishin pjesëmarrës në konferencën shkencore me temën: “Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë”**

Prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku dhe prof. ass. dr Dardan Vuniqi ishin pjesëmarrës në konferencën shkencore me temën: “Terminologjia e fushave humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë.”

Konferenca është organizuar nga Fakulteti i Filologjisë në Tiranë dhe disa fakultete të tjera dhe është mbajtur, më 11.05.2023.

Profesorët e Fakultetit të Filologjisë dhe të Juridikut në Prizren kanë prezantuar për temën: “Roli kuptimor i grupit të fjalëve në terminologjinë e drejtësisë”, kështu që studiuesit i kanë hulumtuar dhe studiuar gjithsej 2612 grupe të fjalëve ose togfjalësha dhe 205 fjalë të përbëra ose kompozita.

Punim ka prurje të reja kuptimore, analizuese e shkencore për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës standarde dhe prurje për pasurimin e terminologjisë së drejtësisë.

Punimi i kompletuar do të botohet sipas rekomandimeve të Fakultetit të Filologjisë në Tiranë, kurse programin e konferencës mund ta gjejnë në këtë link:



**Pjesëmarrja e profesorëve të Fakultetit të Filologjisë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”  
Durrës, më 5 maj 2023**

Në konferencën me temë: “Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”, organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Departamenti i Gjuhës shqipe, pranë Fakultetit të Edukimit, në Durrës, më 5 maj 2023, morën pjesë edhe pesë profesorë të Fakultetit të Filologjisë, të Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren: prof. asoc. dr. Flamur Shala, prof. asoc. dr. Izer Maksuti, prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku, prof. asoc. dr. Teuta Vinca, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe ass. Fjolla Duraku.

Konferenca i zhvilloi punimet paralelisht në 7 panele, ku morën pjesë studiues prej disa universitetesh, si: nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe senatori i Fakultetit, prof. asoc.dr. Izer Maksuti patën takime edhe me dekanën e Fakultetit të Edukimit, prof. dr. Klodiana



Leka dhe me përgjegjësen e Departamentit të Gjuhës Shqipe, prof. ass. dr. Edlira Abdurahmani, ku u bisedua për mundësi të bashkëpunimit ndëruniversitar.

Linku i programit të konferencës: <https://uamd.edu.al/programi-perfundimtar-i-konferences-se-pare-shkencore-ne-gjuhesi-5-maj-2023/>



### **Bordi Këshillëdhënës Industrial i Fakulteti të Filologjisë mbajti mbledhjen e radhës**

Në sallën mbledhjeve të Fakultetit të Filologjisë, më 28.03.2023, u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Industrial të Fakulteti të Filologjisë me këtë rend dite:

Diskutim dhe shqyrtim për RVV-në e programit studimor master “Letërsi, Kulturë dhe Shoqëri”;

Rekomandime të BKI-së për programet e studimeve (GJLSH, GJLA, GJLGJ) dhe për programin e studimeve master “Letërsi, Kulturë dhe Shoqëri” (GJLGJ), që është në proces të akreditimit.

Të tjera.



### **50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit**

Sot në Tiranë ka vazhduar Konferenca shkencore “Një komb – një gjuhë”, e cila po kremton pesëdhjetëvjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit.

Në këtë Konferencë kontribuan mbi shtatëdhjetë studiues të ndryshëm.

Nga Fakulteti i Filologjisë me një kumtesë ka kontribuar dhe prezantuar prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku.



## Një komb – një gjuhë

Prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku ishte kumtues në konferencën shkencore që është organizuar nga Instituti i Albanologjisë në Prishtinë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, në Tiranë dhe nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Profesor Millaku ishte drejtues i seancës së dytë shkencore dhe kumtues me temën: “Çështje morfosintaksore në Projektin e drejtshkrimit të vitit 1967”.

A. Kostallari ka thënë: “Projekti i 1967-ës ka 255 rregulla e 57 përjashtime e sqarime. Ky nuk është numër i madh, po të kemi parasysh që disa nga gjuhët më të mëdha të Evropës, të cilat kanë drejtshkrime me 400 e 500 rregulla. Por ne mund ta pakësojmë edhe më tej numrin e përjashtimeve e të sqarimeve”.

Millaku në kumtesën e tij ka prezantuar dhe trajtuar dymbëdhjetë çështje morfosintaksore.



### Konferenca e Shkupit, 21.11.2022

Në Fakultetin e Filologjisë, në Shkup, sot më 21.11.2022 kisha nderin të jemi pjesë e konferencës shkencore: “50 vjet gjuhë, letërsi e kulturë shqiptare, në Fakultetin e Filologjisë në Shkup; 50 vjet shkruajmë e flasim njësoj”.

Albanologjia në përgjithësi dhe gjuha shqipe në veçanti, ashtu si gjithë populli shqiptar, në etapa e caktuara nuk është investuar e vlerësuar në nivelin e kërkuar e merituar, por falë vigjilencës

suaj e të shoqërisë në përgjithësi, sot shqipja dhe shoqëria është duke ecur me këmbë të lënuara, por me ballë të hapur e krenare dhe e unifikuar me alfabetin perëndimor dhe me gjuhë të kodifikuar.

Kumtesën time analizuese do ta fokusoj në një çështje sfiduese për gjuhën, shoqërinë dhe për studiuesit e gjuhës në veçanti, pra duke u fokusuar në temën: “Shqipja përballë terminologjisë së huaj profesionale”.

Zhvillimet e reja teknologjike dhe ato të fushave të ndryshme profesionale na kanë sjellë risi dhe sfida gjuhësore.

Terminologjia është tërësia e termave të një fushe të shkencës, si ajo e gjuhës, e kulturës, e teknikut, e juridikut, e bujqësisë, e psikologjisë, e informatikës, e artit, e jetës shoqërore, e politikës, terminologjisë popullore etj. Dihet se në shkencë shprehet më së miri aftësia e njeriut për të vëzhguar, për të analizuar dhe për të studiuar çdo fenomen të mundshëm, shkencor apo edhe si terme me përmbajtje gjuhësore. Termi rëndom përdoret në botimet shkencore (në libra, revista, artikuj, punime) dhe në kumtimet gojore (në konferenca, sesione, simpoziume, leksione, diskutime etj.). Përdoret në fushën e veprimtarisë shkencore, si në: gjuhësi, histori, etnologji, etnografi, arkeologji, matematikë, kimi, fizikë, biologji, mjekësi, bujqësi, teknik, astronomi, në artin figurativ e muzikor dhe në informatikë etj.



## **Dy profesorë të Fakultetit të Filologjisë morën pjesë në konferencën e Shkupit**

Dekani i Fakultetit të Filologjisë prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe prof. asoc. dr. Izer Maksuti profesor në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, morën pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare dyditore, 29 dhe 30 shtator 2022 me temë “Çështje të standardizimit të toponimisë në RMV”, organizuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së në Shkup.

Në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, në amfiteatrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Agjencia organizoi konferencën e tretë me radhë që nga themelimi i saj, me pjesëmarrës prej disa institucioneve shkencore dhe arsimore nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nga rajoni, si: Tirana, Elbasani, Durrësi, Korça, Ulqini, Prishtina, Prizreni, Gjilani etj.

Në konferencë u prezantua edhe botimi i kumtesave të konferencës së dytë, mbajtur vitin e kaluar, me temën “Terminologjia dhe roli i saj në njohjen e gjuhës profesionale”, për të cilën folën prof. Xhafer Beqiraj, nga Universiteti “Ukshin Hoti”- Prizren, si dhe dr. Zeqirja Ibrahim, nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Shkup.

Punime shkencore në këtë libër kanë edhe dy profesorët tanë, ndërsa recensionin e prof. Xhafer Beqiraj për këtë vëllim, do të botohet vitin e ardhshëm bashkë me kumtesat e konferencës së sivjetme.

Prof. Izer Maksuti mbajti kumtesën me temën “Toponimia nga këndvështrimi i politikës gjuhësore në shembullin e Tirolit të Jugut dhe Austrisë”.

Dy profesorët tanë, më 30 shtator, po ashtu ishin pjesë e emisionin të mëngjesit të Radio Shkupit, ku u bisedua për konferencën, promovimin e botimit, rëndësinë e temës së “Standardizimit të toponimisë” si dhe për Ligjin e gjuhëve dhe procesin e zyrtarizimit të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut.



## Pjesëmarrja në Konferenca shkencore ndërkombëtare

Prof. ass. dr. MANJOLA BRAHAJ HALILI

**PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT SHKENCOR PËR PERIUDHËN 01.10.2022 – 01. 10. 2023**

Konferenca shkencore:

*“Education and development” Organizuar nga Kolegji UBT*

*Prishtinë, 29 – 30 tetor 2022*

*Link: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2022/all-events/312/>*



Artikulli

*“Posthumanism and The Role of technology: Between Myth and metaphor in H.G. Well’s Dystopian Novel the Time Machine”*

*Revista*

**Euroasian Journal of Applied Linguistics, (2022), 8 (2): 249 – 258.**

**Link:**

<https://ejal.info/menuscript/index.php/ejal/article/view/333>

Artikulli 3

*“Methods, Models and Strategies for Studying Lyrical Text”*

*Revista*

**Res Militaris, (2023), 13 (3): 18 – 28**

**Link:** <https://resmilitaris.net/menu-script/index.php/resmilitaris/article/view/3219>

**ALBANOLOGJIA DJE, SOT DHE NESËR (në 70-të vjetorin e themelimit të Institutit Albanologjik)**

**Prishtinë 19 – 21 qershor 2023**

***Kumtesa “Veçoritë, roli dhe aspekte të veçanta të qasjeve psikoanalitike në kritikën letrare shqipe”***



**Prof. asoc. dr. TEUTA VINCA KAFEXHOLLI** mori pjesë në *Seminarin XVI Ndërkombëtar të Albanologjisë, Tetovë, më 28 shtator 2022*

Titulli i kumtesës: **“Vlera e një parathënie me përmasa eseistike”.**




**Konferenca ndërkombëtare në gjuhësi- Organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Gjuhës shqipe  
Durrës, 5 maj 2023**

*Kumtesa e prof. asoc. dr. Teuta Kafexhollit mban titullin: “Veçantitë e gjuhës në prozën e Kuetlit”  
Artikulli 3 “Arsimi dhe hapja e shkollave shqipe në një revistë të rëndësishme”*

Revista ANAS Studia humanitatis, vëllimi 10, nr. 22, maj 2023Ë 47-56.

ISSN:1857-8896

<https://mail.google.com/mail/u/0/#search/meral/FMfcgzGsmhcJxHzzmxrrzQlnHmFgNXWR?projector=1&messagePartId=0.1>





*Artikulli “The Traditions of Albanians and Their Portrait in Childe Harold’s Peligrimage”*

Revista Pakistan journal of Life and Social Sciences, (2023), 2(1): 286 – 293.

Link:

[https://www.pjlss.edu.pk/pdf\\_files/2023\\_1/286-293.pdf](https://www.pjlss.edu.pk/pdf_files/2023_1/286-293.pdf)

### **Me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit**

Me rastin e 50-vjetorit të KONGRESIT të DREJTSHKRIMIT, më 17.11.2022, prof. asoc. dr. Flamur Shala mori pjesë në Konferencën shkencore “Shqipja standarde sot”, të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Në konferencë morën pjesë anëtarë të të dy akademive dhe studiues të gjuhësisë shqiptare nga universitetet vendore dhe ndërkombëtare.



### **Prof. asoc. dr. Flamur Shala mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**

Prof. asoc. dr. Flamur Shala mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (XLI), organizuar nga Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës. Në këtë veprimtari shkencore prof. Shala u paraqit me kumtesën më titull: “*Paskajorja e tipit ‘me shkue’ dhe lidhja ‘të shkoj’ – prejardhja, ngjashmëritë dhe dallimet*”.

Në Seminarin XLI morën pjesë studiues të njohur nga të gjitha trojet shqiptare dhe studiues nga vende të huaja.



**Pjesëmarrja e profesorëve të Fakultetit të Filologjisë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”  
Durrës, më 5 maj 2023**

Në konferencën me temë: **“Ligjërimi i shkruar dhe i folur, probleme reale dhe propozime konkrete për zgjidhjen e tyre”**, organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Departamenti i Gjuhës shqipe, pranë Fakultetit të Edukimit, në Durrës, më 5 maj 2023, morën pjesë edhe pesë profesorë të Fakultetit të Filologjisë, të Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren: Prof. asoc. dr. Flamur Shala, prof. asoc. dr. Izer Maksuti, prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku, prof. asoc. dr. Teuta Vinca, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe ass. Fjolla Duraku.

Konferenca i zhvilloi punimet paralelisht në 7 panele, ku morën pjesë studiues prej disa universitetesh, si nga: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe senatori i Fakultetit, prof. asoc.dr. Izer Maksuti patën takime edhe me dekanen e Fakultetit të Edukimit, prof. dr. Klodiana Leka dhe me përgjegjësen e Departamentit të Gjuhës Shqipe, prof. ass. dr. Edlira Abdurahmani, ku u bisedua për mundësi të bashkëpunimit ndëruniversitar.

Linku i programit të konferencës: <https://uamd.edu.al/programi-perfundimtar-i-konferences-se-pare-shkencore-ne-gjuhesi-5-maj-2023/>

## Fikret Ramadani u dekorua me “Medalje të Artë” nga Universiteti i Tiranës

Gjatë periudhës kohore 2017 – 2019, ass. Fikret Ramadani ka studiuar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Duke vlerësuar punën dhe arritjet e larta në studime gjatë këtyre viteve, këto ditë, Rektori i Universitetit të Tiranës, të njëjtit i ka ndarë një Certifikatë dhe një Medalje Ari me këtë motivacion:

*Për përfundim me rezultate shumë të larta të programit të studimit “Master i Shkencave në Letërsi (Letërsi e përgjithshme dhe e krahasuar)” gjatë periudhës 2017 – 2019, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës.*

Ky shpërblim i veçantë do të jetë motiv shtesë që mësimdhënësi të vazhdojë edhe më tej drejt sukseseve akademike.



### **Ass. Fikret Ramadani, pjesë e sesionit informues për shërbimet e këshillimit akademik dhe psikologjik**

Me rastin e fillimit të semestrit veror 2022 -2023 në Universitetin “Ukshin Hoti”- Prizren, të mërkurën është mbajtur një sesion informues për shërbimet e reja për suksesin e studentëve, këshillimin akademik dhe këshillimin psikologjik.

Në këtë organizim, ass. Fikret Ramadani para studentëve shpalosi detyrat e këshilltarëve akademikë në secilën njësi akademike. Ai bëri të ditur se nën drejtimin e përgjithshëm të dekanit nga secili fakultet dhe në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës, këshilltari akademik koordinon aktivitete këshilluese për studentë në lidhje me programet studimore, suksesin akademik dhe

bashkëpunon ngushtë me studentët tutorë dhe Qendrën e Karrierës, për orientim të studentëve në profesionin e ardhshëm.

Fikret Ramadani, aktualisht është këshilltar akademik në Fakultetin e Filologjisë.



### **Prof. asoc. dr.Vjollca Dibra pjesë e konferencës “World Woman Conference”**

Më datë 18-19 shtator ka marrë pjesë në konferencën “World Woman Conference”, që u mbajt në Ankara, Turqi. Punimi i prof. Vjollca Dibra mban titullin: “Gratë si personazhe kryesore në historinë e letërsisë botërore”. Po ashtu, profesoresha moderoi sesionin e datës 19 shtator.

## **Ass. Fikret Ramadani PhD (c), mori pjesë në konferencën e Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë**

Ass. Fikret Ramadani PhD (c), mori pjesë në konferencën shkencore “Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi”, organizuar nga Departamenti i Studimeve Letrare (IGJL), Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Në këtë konferencë të rëndësishme për dijet albanologjike, asistenti ishte bashkëdrejtues i seancës plenare dhe referues me këtë temë: *“Rubairat” në letërsinë shqipe – autenticiteti dhe apokrifiteti*. Kumtesa u vlerësua me interes nga studiuesit e letërsisë.



## Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Prof. Sejdi Sejdiu mori pjesë në konferencën e 7-të “EMI, ICLHE and Englishization: Reflecting on the changing university”, që u mbajt në Universitetin e Maastrichtit, në Holandë, nga 18 deri më 21 tetor 2022. Prof. Sejdiu, së bashku me kolegë të tjerë prezantuan hulumtimin ‘University language policy as motor of national intergroup cohesion’, që ishte projekt i përbashkët mes Universitetit të Prizrenit dhe Universitetit të Vjenës.




### **University language policy as motor of national intergroup cohesion in Kosovo**

**HERAS K-06-2021**

*Julia Hüttner, Sejdi Sejdiu, Rezarta Ramadani, Dorinë Rakaj  
Tatjana Bacovsky, Christiane Dalton-Puffer, Karen Schramm*

**Në zyren e Erasmus+ u publikua raporti për gjendjen e Arsimit të Lartë në Kosovë,  
ku Prof. Sejdi Sejdiu është bashkautor i raportit**



**Në Shkodër u mbajt punëtorja për përcjelljen e të dhënave të projektit QUADIC. Partneret e projektit QUADIC paraqitën të arriturat e tyre në fushën e ndërkombëtarizimit të universiteteve në Kosovë dhe Shqipëri**



**Në Universitetin e Ferizajt u paraqitën të arriturat e projektit QUADIC në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar nga parnterët e projektit**



Në Universitetin e Prishtinës u mbajt punëtorja përmbyllëse dyditore të projektit: “Zhvillimi cilësor i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe menaxhimit të projekteve” – QUADIC. Punëtorja i zhvilloi punimet më 5 dhe 6 qershor 2023 në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ku morën pjesë universitetet partnere dhe të Zyrës së Erasmus+ në Kosovë.



Në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, u mbajt një tryezë diskutimi e ekspertëve për reforma në arsimin e lartë me temë: Njohja, perceptimi dhe kompetenca në gjuhën angleze e personelit akademik të universiteteve publike në Kosovë.





1. Prof.asoc.dr. Sermin Turtulla mori pjesë në “Kongresin e VIII Ndërkombëtar të Shkencave Shoqërore INCSOS” me punimin “Përdorimi i mjeteve pamore për ndaljen e aktiviteteve në klasë”. Ky kongres ndërkombëtar u mbajt në tetor të vitit 2022 ndërsa u organizua nga Universiteti i Tekirdağut “Namık Kemal” në bashkëpunim me Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik (Maqedoni) nën mbështetjen e kryetarit të kuvendit, prof. dr. Mustafa Şentop. Profesoresha Turtulla u ftua si folëse nga Kosova dhe e Universtietit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për të marrë pjesë në panelin e titulluar “E ardhmja e Ballkanit dhe Turqia”.





2. Në muajin qershor, prof. asoc.dr. Sermin Turtulla mori pjesë në trajnimet e organizuar nga QPM-ja e UUHP me titull “Taksonomia e Blumit” dhe “Rezultatet e të nxënit” të mbajtur nga trajneret e këtij universiteti. Trajnimet ofruan mundësinë e shkëmbimit të njohurive që trajnerët e universitetit kishin fituar nga projekti HERAS për certifikimin e trajnerëve për mësimdhënës.



3. Në muajin qershor, prof.asoc.dr. Sermin Turtulla u angazhua si trajnere në “CACTUS Education” për përgatitjen e maturantëve për testin e maturës shtetërore 2023. Me këtë rast, profesoresha mbajti tri trajnime për një numër maturantësh të interesuar për pjesën e gjuhës angleze, si lëndë në maturën shtetërore.

4. Në muajin korrik, prof.asoc.dr. Sermin Turtulla gjithashtu mori pjesë në trajnimin me titull “Praktika e strukturuar” dhe në punëtorinë me titull “Hyrje në klasat me nxënien në qendër”. Të dy trajnimet janë organizuar nga IOWA State University në bashkëpunim me “Qendrën kosovare për edukim”. Trajnimet janë ofruar në kuadër të projektit “Lea/Rn” që i dedikohet promovimit, përparimit dhe zhvillimit të të nxëniet. Ndërsa u mbajtën nga kuadri akademik i Iowa State University, dr. Jan Wiersema dhe mbështetur nga dr. Curt Youngs, profesor me nderin “Morrill”.

5. Në muajin korrik, prof. asoc. dr. Sermin Turtulla, në cilësinë e koordinatorës së Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie, bashkë me rektorin e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, prof. asoc. dr. Mentor Alishani, prorektorin për marrëdhënie me jashtë dhe cilësi prof. asoc. Serdan Kervan dhe, sekretarin e UPZ-së, z. Nexhmedin Krasniqi, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi midis “Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie” e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe “Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie” e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”. Ata u pritën nga rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Qerim Qerimi, i shoqëruar nga prorektorja për akreditim, cilësi të mësimin dhe çështje të studentëve, prof. dr. Njomza Llullaku dhe prof. Eda Vula, shefe e QPM-së së UP-së. Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin akademik dhe profesional me qëllim të dobisë së ndërsjellë duke arritur një marrëveshje më të ngushtë për shkëmbime në fushën e arsimit universitar, trajnimin akademik, hulumtimin/ kërkimin shkencor dhe aktivitetet e tjera në frymën e njëjtë.



6. Prof. asoc. dr. Sermin Turtulla, në cilësinë e koordinatorës së Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie, mori pjesë në trajnimin katër-ditor me titull “Trajnimi i Trajnerëve (TT) të

Certifikuar të Paneleve Korporative” të cilin e udhëhoqi ekspertja për arsimin e bazuar në kompetenca, prof. Monica Dryer Rossi nga Universiteti i Iowa-s. Trajnimi është pjesë e projektit “Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë” të financuar nga USAID dhe i udhëhequr nga Universiteti i Iowa-s (UI) në partneritetet me Universitetin Shtetëror të Iowa (USI) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).



7. QPM-ja e UUHP-së e kryesuar nga prof. Sermin Turtulla organizoi punëtori për hulumtime dhe kërkime të mbajtur nga Jaime S. Rubin, studiuese e Fulbright-it në MASHT. Prof. Jamie është profesoreshë në Universitetin e Kolumbiasë së Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo ka mbajtur një sërë pozicionesh të nivelit të lartë në “Qendrën Mjekësore” të Universitetit të Kolumbiasë dhe është njëkohësisht themeluese e zyrës së administrimit të kërkimeve, zëvendës kryetare për zhvillimin e hulumtuesve dhe administrimin e kërkimeve. Me këtë rast prof. Jamie S. Rubin dhe prorektorja prof. Serdan Kervan ndanë edhe certifikatat për pjesëmarrësit.



## **Pjesëtarët e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze pjesëmarrës në Konferencën e Universitetit të Mاستrihtit**

Pas një pune dyvjeçare në projektin CMI Vienna-Kosovo, financuar nga Heras+, tre anëtarë të Departamentit të Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze, të shoqëruar nga profesorë të Universitetit të Vjenës, po prezantojnë gjetjet e tyre në Konferencën e Universitetit të Mاستrihtit. Profetori Sejdi Sejdiu dhe dy asistentet Dorine Rakaj dhe Rezarta Ramadani, më 19.10.2022, kanë prezantuar të gjeturat e hulumtimit që është realizuar në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.



## **Ambasadori amerikan, Jeffrey Hovenier, ka vizituar Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren**

Ambasadori Amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, të premtën më 16.12.2022, ka vizituar Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, dhe ka ligjëruar me studentët për sundimin e ligjit, sigurinë dhe politikën e jashtme. Ambasadorja Hovenier paraprakisht u prit nga rektori prof. assoc. dr Samedin Krrabaj dhe stafin e tij drejtues. Rektori Krrabaj shprehu mirënjohjen e tij për Shtetet e Bashkuara për mbështetjen e vazhdueshme të Universitetit prej vitesh në projekte të ndryshme. Ambasadori shprehu mirënjohjen e tij për pritjen e ngrohtë në Universitet.



### **U mbajt tryezë me temë: “Njohja, perceptimi dhe kompetenca në gjuhën angleze e stafit akademik të universiteteve publike në Kosovë”**

Më 20.06.2023 në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren u mbajt një tryezë e rumbullakët e ekspertëve për reformat në arsimin e lartë me temë: “Njohja, perceptimi dhe kompetenca në gjuhën angleze e stafit akademik të universiteteve publike në Kosovë”.

Fjalën e hapjes në këtë takim e mbajti Rektori i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, prof. asoc. dr. Mentor Alishani, i cili i falënderoi të pranishmit dhe theksoi se njohja e gjuhës angleze nga personeli akademik i universiteteve është i domosdoshëm për të përmirësuar komponentët kryesorë të ndërkombëtarizimit, si bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës. Për ndërkombëtarizim efektiv dhe të suksesshëm në arsimin dhe shkencën, është e rëndësishme që personeli akademik të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze, perceptim pozitiv ndaj gjuhës angleze dhe kompetencë të lartë në përdorimin e saj. Kjo do të ndihmojë në krijimin e ambienteve të hapura dhe të përkushtuara për shkëmbimin e ideve dhe përparimin e njohurive në nivel ndërkombëtar.

Znj. Mimika Dobroshi, Koordinatore e Zyrës Erasmus+ në Kosovë theksoi se njohja, perceptimi dhe kompetenca e stafit akademik në gjuhën angleze kanë një rëndësi të veçantë për ndërkombëtarizimin në kontekstin e universiteteve. Nëpërmjet njohjes së gjuhës angleze, personeli akademik mund të marrë pjesë në projekte bashkëpunimi, të publikojë punime shkencore në revista

ndërkombëtare dhe të përfitojë nga shkëmbimi i ideve dhe njohurisë në nivel global. Perceptimi pozitiv i gjuhës angleze nga stafi akademik do të inkurajojë përdorimin aktiv të gjuhës dhe të ndihmojë në ndërtimin e një mjedisi ku gjuha angleze përdoret me lehtësi dhe besim. Për të përmirësuar njohjen, perceptimin dhe kompetencën në gjuhën angleze të stafit akademik të universiteteve, mund të implementohen strategji dhe politika të ndryshme. Këto mund të përfshijnë trajnime të vazhdueshme të gjuhës angleze, kurset e specializuara në komunikimin akademik në gjuhën angleze, përkrahje për publikimin e punimeve shkencore në gjuhën angleze dhe përdorimin e teknologjisë informative për të rritur përdorimin e gjuhës angleze.

Prof. asoc. dr. Sejdi Sejdiu, Ekspert për Reforma në Arsimin e Lartë dhe profesor në Universitetin “Ukshin Hoti” në programin e Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze, së bashku me studenten Afërdita Ninaj prezantuan hulumtimin e bërë në temën “Njohja, perceptimi dhe kompetenca në gjuhës angleze e personelit akademik të universiteteve publike në Kosovë”. Sipas të gjeturave të hulumtimit, më shumë se 70% e personelit akademik të universiteteve publike në Kosovë i kanë vetëvlerësuar njohuritë e tyre në gjuhën angleze në nivelin mesatar dhe mbi mesatar, ndërsa janë deklaruar të vetëdijshëm për rëndësinë e gjuhës angleze për ndërkombëtarizim, mobilitete, shkëmbime akademike, cilësi të mësimdhënies, dhe publikim të punimeve të tyre shkencore. Hulumtuesit propozuan që zotërimi i gjuhës angleze të jetë kriter për personelin akademik, institucionet e arsimit të lartë të ofrojnë programe studimi në gjuhën angleze, të zhvillojnë programe të përbashkëta me institucione vendore, rajonale dhe evropiane, të zhvillojnë programe sipas standardeve evropiane, dhe të përfitojnë nga programet e Erasmus+, Horizon Europe, Heras+, etj.





### **Aktiviteti studimor i rradhës i studentëve të degës - Gjuhë dhe Letërsi Gjermane me ÖAD austriake**

“Memory Walk” në Prishtinë: kujtimi, reflektimi, ecja.

Faleminderit Dr. Franz Schörkhuber, Korab Krasniqit, Alexander V. (forum ZFD) dhe Verena Walzl (ÖAD Prishtina). Falenderojmë gjithashtu të gjithë studentët për bashkëpunimin e tyre të guximshëm në formën e përkthimeve (shqip-gjermanisht).





## **Bashkëpunimi akademik ndërmjet Universitetit Hildesheim dhe Universitetit Hannover nga Gjermania me Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren**

Më 02.09.2022 në hapësirat e kampusit të Universitetit “Ukshin Hoti” u realizua takimi ndërmjet përfaqësuesve të Universitetit Hildesheim nga Gjermania, në krye me prof. Annette Lützel (Koordinatorë e projekteve për mësim të gjuhëve të huaja) dhe studentëve nga Universitetet Hildesheim dhe Hannover me profesorë nga dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren.

Grupi i studentëve nga Gjermania po qëndron për praktikë në shkollën “Loyola-Gymnasium” dhe në kuadër të bashkëpunimit që ka Universiteti i Prizrenit me shkollën “Loyola” u zhvillua edhe ky takim.

Takimi ishte mjaft i frytshëm për të dy palët, duke qenë se prof. Lützel shprehu gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit duke u shprehur e hapur për shkëmbime akademike të mësimdhënësve nga kjo degë me Universitetin Hildesheim. Në këtë takim u prezantuan edhe mundësitë të cilat ofron Universiteti i Prizrenit për studentët ndërkombëtar (si p.sh. shkolla verore) dhe vet dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane.

<https://filologjia.uni-prizren.com/bashkepuniimi-akademik-ndermjet-universitetit-hildesheim-dhe-universitetit-hannover-nga-gjermania-me-universitetin-ukshin-hoti-prizren/>



**Prof. Asoc. Dr. Ilir Krusha botoi librin “Die formalen und semantischen Eigenschaften der Satzarten im Albanischen und Deutschen”**



## **“Dita e mirëseardhjes” për studentët e rinj të Fakultetit të Filologjisë**

Në Fakultetin e Filologjisë u shënuar Java e mirëseardhjes. Studentët e regjistruar në vitin e parë, sot më 06.10.2023, patën mundësi të njoftohen me programet studimore në Fakultetin e Filologjisë.

Me një fjalim përshëndetës, studentëve të rinj u drejtua dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj. Ai theksoi se zgjedhja e Fakultetit të Filologjisë është alternativ e qëlluar. Me një staf akademik të përgatitur që ka në përbërje kjo njësi akademike dhe me angazhimin tuaj, sukseset do të diskutohen, vazhdoi dekani Beqiraj. Krejt në fund, bëri me dije se studentët do të kenë përkrahjen e vazhdueshme të dekanatit.

Më pas, kryetarja e Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, Olza Shemsidini, mbajti një fjalim, ku u fokusuan në mbështetjen e saj për studentët e rinj.

Ndërkaq, shefi i degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, ass. Fikret Ramadani, bëri prezantimin e programit në fjalë.

Në vazhdim, prodekana e Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Sermin Turtulla bëri prezantimin e programit Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Ndërsa, shefi i degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, prof. asoc. dr. Ilir Krusha, bëri prezantimin e programit të degës në fjalë.

Në fund, studentët u njoftuan me bibliotekën dhe ambientet e Fakultetit të Filologjisë.

<https://filologjia.uni-prizren.com/ne-fakultetin-e-filologjise-u-shenua-java-e-mireseardhjes/>



### **Vizita e Ambasadorit të Austrisë z. Christoph Weidinger**

Prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj Rektor i Universitetit “Ukshin Hoti”= Prizren të premten, më 18.11.2022, ka pritur në takim Ambasadorin e Austrisë z. Christoph Weidinger.

Gjatë takimit palët u dakorduan rreth vazhimit të bashkëpunimit shumë të frytshëm ndërmjet Universitetit e në veçanti të programit të Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane – Fakulteti i Filologjisë, me shtetin austriak. Ky bashkëpunim do të avancohet edhe në aspekte tjera, si me universitetet në Austri në fushën e shkëmbimit akademik por edhe të literaturës austriake.

<https://www.uni-prizren.com/rektori-krrabaj-ka-pritur-ne-takim-ambasadorin-e-austrise-z-christoph-weidinger/>



### **Konferenca mbi “Studimet albanologjike në gjuhën gjermane”**

Në kuadër të edicionit të katërt të manifestimit kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit – 2022” (14-22 nëntor) me temë “**Studimet albanologjike në gjuhën gjermane**” organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më datë 16 nëntor 2022, morën pjesë 3 profesorë të Fakultetit të Filologjisë, të Universitetit “Ukshin Hoti”- Prizren.

Dekani prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj dhe prof. ass. dr. Vilson Marku kishin kumtesën: “*Gustav Meyer dhe dorëshkrimi ‘Albanesische Grammatik’ e vitit 1886*”, ndërsa prof. asoc. dr. Izer Maksuti mbajti kumtesën me titull: “*Ndihmesa e Maksimilian Lamercit për njësimin e gjuhës së përbashkët letrare shqipe*”.

Kjo pjesëmarrje ishte edhe në frymën e realizimit të marrëveshjes për bashkëpunim, nënshkruar nga të dy institucionet tona, për shkëmbim përvojash dhe organizim të përbashkët të veprimtarive shkencore.

<https://www.itsh.edu.mk/kontributet-me-vlera-kolosale-te-studiuuesve-gjerman-ditet-e-alfabetit-ne-itshksh/>

<https://filologjia.uni-prizren.com/pjesemarrja-ne-konferencen-mbi-studimet-albanologjike-ne-gjuhen-gjermane/>



### **Ambasadori gjerman Rohde ka vizituar Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren**

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jörn Rohde, të enjten, më 24.11.2022, ka vizituar Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren. Gjatë takimit palët u dakorduan rreth vazhimit dhe thellimit të bashkëpunimit ndërmjet UUHP e në veçanti të Departamentit të Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane me shtetin gjerman. Ky bashkëpunim bilateral do të avancohet edhe në shumë aspekte tjera; si me universitetet në Gjermani në fushën e shkëmbimit akademik, DAAD, projekte të përbashkëta studimore, bursa studimore, vizita universiteteve në Gjermani por edhe pasurim të bibliotekës gjermane me literaturë të re në këtë gjuhë.

Takimi pastaj vazhdoi edhe me një diskutim shumë konstruktiv të ambasadorit gjerman z. Rohde me studentët dhe stafin mësimdhënës të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane.

<https://www.uni-prizren.com/ambasadori-gjerman-rohde-ka-vizituar-universitetin-ukshin-hoti-prizren/>



## **DAAD nga Gjermania dhe ÖAD nga Austria prezantojnë mundësitë për bursa për studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren**

Në Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren u mbajt takimi informues me studentë, prezantimi i bursave për studime nga Austria dhe Gjermania si dhe mundësitë për studime në shtetet gjermanofolëse. Prezantimi u organizua nga lektori gjerman i DAAD-së prof. Adrian Ramabaja, lektorja nga ÖAD austriake prof. Verena Walzl dhe stafi mësimdhënës i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane.

<https://www.uni-prizren.com/daad-nga-gjermania-dhe-oad-nga-austria-prezantojne-mundesite-per-bursa-per-studentet-e-universitetit-ukshin-hoti-prizren/>



**Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë zt. Jörn Rohde ka mbajtur ligjëratë me temën  
“Bashkëpunimi shtetëror Kosovë-Gjermani” në Universitetin “Ukshin Hoti”,  
Prizren**

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë zt. Jörn Rohde, të martën, më 21.03.2023, ka vizituar Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren. Ai fillimisht është pritur në takim nga rektori, prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj dhe stafi menaxhues. Pastaj, ka vazhduar me mbajtjen e një ligjëratë me studentët dhe stafin e programit të Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane dhe studentët e tjerë të interesuar.

Në takim Rektori Krrabaj e ka falënderuar ambasadorin Rohde për kontributin që ka dhënë shteti gjerman dhe po vazhdon ta jepë për zhvillimin e Kosovës dhe sektorit të Arsimit të Lartë, në këtë kuadër edhe Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren. Rektori po ashtu e njoftoi ambasadorin se Universiteti është pjesë e ITP-Prizren (Parkut i Inovacionit dh Trajnimeve), ku hapësira është siguruar falas.

Ambasadori bëri të ditur se e ka përcjellë zhvillimin e universitetit, sidomos përpjekjet për ndërkombëtarizim dhe Shkollën Verore që është organizuar vitin e kaluar. Rektori e njoftoi ambasadorin se sivjet universiteti do të organizojnë edicionin e dytë të shkollës verore ndërkombëtare më të zgjeruar, ku parashihet që edhe një modul të jetë në gjuhën gjermane dhe se mirëpritet bashkëpunimi me ndonjë universitet nga Gjermania.

Takimi vazhdoi me ligjëratën dhe diskutimet me studentët dhe stafin mësimdhënës të departamentit të Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane.

<https://www.uni-prizren.com/ambasadori-i-gjermanise-ne-kosove-zt-jorn-rohde-ka-vizituar-universitetin-ukshin-hoti-prizren/>



### **Vizita e përfaqësuesve të OeAD**

**Më, 29.03.2023**

Përfaqësuesi i Agjencisë Austriake për Arsim dhe Ndërkombëtarizim – OeAD, dr. Arnulf Knafl me bashkëpunëtorët e tij nga Austria sot takuan rektorin e Universitetit “Ukshin Hoti”- Prizren, prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj, si dhe vizituan kampusin e Universitetit. Palët u dakorduan për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet OeAD austriake (lektoratit austriak) dhe Universiteti “Ukshin Hoti”- Prizren.

<https://www.uni-prizren.com/rektori-krrabaj-priti-ne-takim-perfaqesuesit-e-oead/>





**Departamenti - Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Fakulteti i Filologjisë, Universiteti “Ukshin Hoti” - Prizren në bashkëpunim me ambasadat gjermane, austriake, zvicerane, OeAD, Universiteti i Vjenës, Universiteti i Zürich-ut, Goethe Institut, DokuKino ka organizuar aktivitete të shumta kulturo-shkencore kushtuar festimit të ditëve të Gjuhës Gjermane në Kosovë**

11.05.2023

Dita e parë e kremtimit “Ditët e Gjuhës Gjermane në Kosovë” në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.

Ligjëratë nga prof. dr. A. Millner, Universiteti i Vjenës në bashkëpunim me Ambasadën Austriake në Prishtinë dhe OeAD.

16.05.2023

Dita e dytë “Ditët e Gjuhës Gjermane në Kosovë” në Universitetin “Ukshin Hoti” - Prizren.

1. Ligjëratë nga prof. dr. H. Schoch Umbrich, Universiteti i Zürich-ut, në bashkëpunim me Ambasadën zvicerane në Prishtinë; Tema: Historia e artit gjerman.
2. Vizita dhe prezantimi i monumenteve historike, kulturore dhe religjioze në Prizren nga studentët e Departamentit Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.
3. Mbrëmje filmi gjerman në bashkëpunim me Ambasadën gjermane në Prishtinë, Goethe Zentrum dhe DokuKino.

<https://filologjia.uni-prizren.com/departamenti-gjuhe-dhe-letersi-gjermane-fakulteti-i-filologjise-universiteti-ukshin-hoti-prizren-ne-bashkepunim-me-ambasadat-gjermane-austriake-zvicerane-oad-universiteti-i-vjenes-univers/>



## **Qëndrim njëjavor pune në Universitetin e Hildesheim-it në Gjermani**

Në kuadër të Programit Erasmus + dhe marrëveshjes së nënshkruar në mes Universitetit të Hildesheimit dhe Universitetit “Ukshin Hoti”- Prizren, KA 171, prof. asoc. dr. Izer Maksuti, nga Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Fakulteti i Filologjisë, nga data 19 deri më 26 gusht 2023, pati një qëndrim pune në Universitetin e Hildesheimit.

Udhëtimi dhe qëndrimi ishte bashkërisht me ekipin e gjimnazit “Loyola”, me të cilin të dy universitetet që disa vite kanë një bashkëpunim të suksesshëm. Grupi përbëhej prej drejtoreshës së shkollës, Motër Lindita Spaqi, dy mësuese të gjermanishtes në këtë gjimnaz dhe 3 mësues tjerë të disa lëndëve profesionale në këtë shkollë.

Grupi ka pasur pritje dhe takime pune në Universitetin e Hildesheimit me prorektorin për mësim prof. dr. Jürgen Sander, prof. dr. Jürgen Menthe, nga dega e kimisë, znj. Annete Lützel, drejtuese e projektit për mësimin e gjuhës “Sprachlernprojekt” dhe bashkëpunëtorja e saj, znj. Johanna Scholz.

Prorektori i Universitetit të Hildesheimit bëri një paraqitje të institucionit të tij: historiku, përbërja, fakultetet, fokusi i studimeve, bashkëpunimi ndërkombëtar etj.; pastaj pasuan prezantimet e palës kosovare. Përfaqësuesit e Loyolës prezantuan shkollën dhe aktivitetin e tyre, ndërsa prof. Maksuti bëri një paraqitje të Universitetit “Ukshin Hoti” dhe Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, si dhe një hyrje për mësimin e gjermanishtes në Kosovë. Prof.dr. Jürgen Menthe, foli për sistemin arsimor gjerman, veçoritë dhe specifikat e tyre, ndërsa pastaj bashkërisht u diskutua për të përbashkëtat dhe veçoritë e sistemit arsimor gjerman dhe atij kosovar.

Takime pune ka pasur edhe me dy profesorë të Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane (<https://www.uni-hildesheim.de/fb3/institute/idsl/>) të këtij universiteti, prof.dr. Jochen Heins, drejtues i institutit dhe prof. dr. Ursula Bredel, e pranishme në këtë takim ishte edhe znj. Daniela Puhersch, drejtuese e programit Erasmus + në zyrën për marrëdhënie me jashtë.

Vizitë pune dhe qëndrim në institucionet gjermane, grupi ka pasur edhe në mjediset e një gjimnazi klasik, klasa 9-12, pati njohje me drejtuesit dhe mësime të asistimit gjatë mbajtjes së mësimit. Ky gjimnaz dallohet për nivelin e nxënësve dhe mësime të asistimit, ishte ndër shkollat e pakta që ofron ende mësimin e latinishtes dhe greqishtes së vjetër; shkollë elitare, me nxënës, fëmijë të familjeve të pasura. Vizitë dhe hospitim është bërë edhe në një shkollë fillore, që dallohet për mbajtjen e mësimit të lëndëve profesionale. Organizimi i mësimit në disa lëndë, numri i nxënësve, klasat e përziera me fëmijë me prejardhje nga vende të ndryshme, organizimi i mësimit në gjuhën e prejardhjes ishin disa prej gjërave që u vrojtuan dhe prej temave të shumta që u bashkëbiseduan.

Një ditë përfaqësuesit tanë kanë qëndruar edhe në mjediset e “Leibniz Universität Hannover”. U pritën nga përfaqësuesja e zyrës për marrëdhënie me jashtë, znj. Alexandra Krüger. Pala e këtij universiteti bëri një prezantim të universitetit të tyre, të njësive akademike, të bashkëpunimit ndërkombëtar, të shkollimit të mësueseve, fushat e hulumtimit etj. U bënë vizita dhe shëtitje nëpër mjediset e pafund të kampusit, të gjelbëruar, të universitetit të tyre. Gjatë qëndrimit njëjavor në mjediset e këtyre universiteteve u pritëm tepër ngrohtë, mësuaam mjaft gjëra të reja, morëm frymëzim dhe një sërë idesh me vete, vazhduam dhe zgjeruam bashkëpunimin ndërinstitucional.

Prorektori Sander dhe drejtuesja e projektin znj. Annette Lützel do të qëndrojnë gjatë shtatorit, një javë në Kosovë. Gjatë kësaj kohe do të vizitojnë Universitetin “Ukshin Hoti” dhe shkollën Loyola në Prizren. <https://filologjia.uni-prizren.com/qendrim-njejavor-pune-ne-universitetin-e-hildesheim-it-ne-gjermani/>



### **Profesor Maksuti mbajti ligjëratë të hapur me temë: “Leksiku ndërkombëtar në mësimin e gjuhëve të huaja”**

Profesor Izer Maksuti mbajti ligjëratë të hapur me temë: “*Leksiku ndërkombëtar në mësimin e gjuhëve të huaja*” (Der internationale Wortschatz im Fremdsprachenunterricht).

Prof. asoc. dr. Izer Maksuti, profesor në programin Gjuhë dhe Letërsi Gjermane në Fakultetin e Filologjisë, ka mbajtur ligjëratë të hapur me 16 studentët nga Universiteti i Hildesheimit dhe Universiteti i Hannoverit, ku kanë marr pjesë edhe studentët e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë gjermane, të Universitetit “Ukshin Hoti”, Prizren. Qëllimi dhe përmbajtja e kësaj ligjërata tematike ishte paraqitja e pjesës së përbashkët të leksikut të çdo gjuhe, të atij ndërkombëtar, përkufizimi, tendencat e ndërkombëtarizimit të leksikut, sidomos në vitet e fundit, dobia e përdorimit të tij në

procesin e mësimin të gjuhëve të huaja, vetëdijesimi për rëndësinë e këtyre veçorive të përbashkëta të gjuhëve etj. Meqë pala e studentëve gjermanë shprehën interes për gjuhën shqipe dhe mësimin e saj nga të huajt dhe si gjuhë e prejardhjes në vendet gjermanishtfolëse, Prof. Maksuti, kishte përgatitur edhe një përmbledhje të librave të mësimin të shqipes në gjermanisht, si dhe materiale të tjera të dobishme për shqipen në gjermanisht nga autorë gjermanë dhe shqiptarë.

<https://filologjia.uni-prizren.com/profesor-maksuti-mbajti-ligjerate-te-hapur-me-teme-leksiku-nderkombetar-nemesimin-e-gjuheve-te-huaja/>



**Ligjëratë nga prof. dr. Gisela Müller-Brandeck-Bocquet  
“60 vjet të Traktatit Elysee, marrëdhëniet gjermano-franceze si një “motor  
integrimi” dhe sfidat e reja për Evropën”**

Në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, profesoresha Müller-Brandeck-Bocquet, Drejtuese Jean Monnet për Studime Evropiane dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Würzburgut, mbajti një ligjëratë publike me një temë të rëndësishme për marrëdhëniet ndërmjet Gjermanisë dhe Francës, në kuadër të 60-vjetorit të Traktatit të Elysee. Ligjërata e titulluar “Marrëdhëniet Gjermano-Franceze si Motor i Integrimi dhe Sfidat e Reja për Evropën” u ndoq me interes nga studentë, staf akademik dhe të ftuar të tjerë.

Profesor Müller-Brandeck-Bocquet theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe historisë së pasur të marrëdhënieve gjermano-franceze, të cilat kanë luajtur një rol kyç në ndërtimin e strukturave të Bashkimit Evropian. Ajo gjithashtu u përqendrua në sfidat e reja që Evropa përballon sot dhe rolin që duhet të luajnë Gjermania dhe Franca në zgjidhjen e tyre.

Prof. asoc. dr. Mentor Alishani, rektor i Universitetit “Ukshin Hoti”, e priti në zyrë profesoren dhe e falënderoi për kontributin në promovimin e njohurive dhe debatit të hapur mbi çështje të

rëndësishme evropiane. Rektori Alishani shtoi se Kosova ndihet e privilegjuar që ka një mik të madh dhe të fuqishëm si Gjermania dhe se bashkëpunimi ndërmjet tyre është një përkushtim i vazhdueshëm për të forcuar lidhjet e dy vendeve dhe për të ndihmuar në zhvillimin e Kosovës.

Ndërkaq nga ambasada gjermane, znj, Anja Grossmann, theksoi se Gjermania e mbështet fuqishëm procesin e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Po ashtu ajo shtoi se edhe BE ka nevojë për reformim të brendshëm, që të jetë e aftë për të pranuar anëtar të rinj.

<https://www.uni-prizren.com/prof-muller-brandeck-bocquet-lectures-on-60-years-of-the-elysee-treaty-german-french-relations-as-an-integration-engine-and-europes-new-challenges/>



**Tre mësimdhënës të Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane Prof. asoc.dr. Ilir Krusha, Prof. ass. dr. Shpëtim Zymberaj dhe Prof. asoc. dr. Izer Maksuti morën pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “BRIDGE 2023”**

Në këtë konferencë, të organizuar nga Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren, më 9-10 nëntor 2023, u prezantuan mbi 150 punime nga mbi 200 autorë, nga vendi, rajoni, si dhe më gjerë.

Prof. Shpëtim Zymberaj dhe Prof. Ilir Krusha mbajtën kumtesën me titull: *Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve sipas Metodologjisë Maria Montessori*

Ku folën për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve dhe duke parë nevojën që arsimimi të fillojë qysh në fëmijërinë e hershme, është e rëndësishme që të përdoret metodologji praktike dhe efikase dhe njëra ndër to, është edhe metodologjia e Maria Montessorit e cila është treguar mjaft efikase. Mund të themi se metodologjia Montessori, sipas AMI-it (Association Montessori Internationale), është ndër metodologjitë e rralla që i ka bërë ballë kohës duke i qëndruar besnike shtrirjes së saj origjinale e cila është themeluar para shumë dekadash dhe vazhdon të jetë frytdhënëse dhe efikase në kopshte të njohura fëmijësh edhe në ditët e sotme.

Prof. Maksuti këtu mbajti kumtesën me titull: *“Ndërgjegjësimi gjuhësor si mjet i planifikimit dhe politikës gjuhësore”*. Ai foli për rëndësinë e ndërgjegjësimit gjuhësor, si në pjesën e komunikimit dhe përdorimit të përditshëm të gjuhës, ashtu edhe në procesin e mësimin të gjuhëve dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore, si dhe për rëndësinë e gjuhëve në fushën e arsimimit dhe të punësimit. Pjesë të këtij procesi të ndërgjegjësimit gjuhësor janë edhe rëndësia e ruajtjes së larmisë gjuhësore, vlerësimi dhe kultivimi i shumëgjuhësisë, shmangia e gjuhës së urrejtjes, respektimi i të drejtave gjuhësore etj. Po ashtu, ai bëri një përshkrim të procesit të ndërgjegjësimit qytetar e kombëtar, për domosdoshmërinë e edukimit gjuhësor në shkollë, rritjen e kulturës gjuhësore, si dhe përmirësimin e statusit dhe të drejtave gjuhësore. Ndër të tjera u diskutua edhe për dukurinë e shkeljeve të normës gjuhësore nga përdoruesit në institucionet arsimore dhe të administratës shtetërore, në disa rrafshë, si në atë fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor etj. Pikërisht për këtë duhen bërë në vazhdimësi fushata ndërgjegjësimi, si për mësimin dhe zotërimin e gjuhës standarde, ashtu edhe për përdorimin e drejtë dhe të duhur të normës gjuhësore, në të shkruar dhe në të folur.

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane ekziston që nga themelimi i universitetit tonë (2010) dhe ka bashkëpunim shumë të frytshëm me institucione të vendit, rajonit, sidomos me ata të vendeve gjermanishtfolëse. Nga viti 2014 kultivohet kooperimi ndërinsitucional me Shkëmbimin Akademik Austriak OeAD, i cili ka dërguar një lektor të gjuhës gjermane në Degën e gjermanistikës, si pjesë e Fakultetit të Filologjisë. Prej vitit 2018 pjesë e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane është edhe Biblioteka e specializuar e gjermanistikës, me mbi 5 mijë libra, kryesisht të dhuruara nga Universiteti i Vjenës, Instituti i Gjuhësisë dhe Instituti i Gjermanistikës.

<https://filologjia.uni-prizren.com/tre-mesimdhenes-te-deges-se-gjuhes-dhe-letersise-gjermane-prof-asoc-dr-ilir-krusha-prof-ass-dr-shpetim-zymberaj-dhe-prof-asoc-dr-izer-maksuti-moren-pjese-ne-konferencen-ii-te-shkencore-nderkombe/>



**Përurimi i librit: “Gjermania dhe Kosova: Historia e një partneriteti”. Autorët: Enrico Seewald (Ed.), Urs Unkauf. Me ekzemplar të nënshkruar nga Co. Autori Ambasadori gjerman në Prishtinë z. Jörn Rohde, për degën Gjuhë dhe Letërsi Gjermane të UUHP në Prizren**

